

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА ASSEMBLY OF KOSOVO

**Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 02
Data 14. 02. 2008**

P R O C E S V E R B A L

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Të pranishëm në mbledhje ishin:
Shkumbin Demalija, Bojan Stojanovič, Emrush Xhemajli, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu,
Agim Veliu, Naim Maloku, Gani Geci dhe Zylfi Merxha

Mungoi: Bujar Bukoshi

Nga zyra mbështetëse morën pjesë: Ibush Mujaj,
Antigona Ibraj, Nur Çeku, Biljana Petrovič

Mbledhja filloi në orën 12:00 në sallën N-225, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës.

Në fillim të mbledhjes kryetari i Komisionit, pasi falënderoi anëtarët për pjesëmarrjen në mbledhje, propozoi të vazhdonte mbledhja me këtë rend dite:

RENDI I DITËS

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit të datës 06.02.2008**
- 3. Shqyrtimi i projekt buxhetit për vitin 2008**
- 4. Shqyrtimi i planit të punës së komisionit**
- 5. Njoftimi nga OSBE për datat e trajnimit**
- 6. Te ndryshme**

Pika e parë: Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Pika e dytë: Procesverbalit nga mbledhja e datës 06.02.2008, u miratua pa vërejtje.

Pika e tretë: Në lidhje me shqyrtimin e projekt buxhetit për vitin 2008, kryetari i komisionit tha, ne e dimë se për shqyrtimin e buxhetit është afat shumë i shkurt për ta shqyrtuar, sepse ky buxhet duhet të miratohet sa më shpejt, prandaj unë propozoj që ne së bashku ta rezervojmë të drejtën e rishikimit të projekt buxhetit në gjashtë mujorin e dytë.

Naim Maloku theksoi se: kur është shpërnda projektbuxheti unë kam kërkuar me shkresë zyrtare prej mekanizmave që ky komision i mbikëqyrë, se a kanë vërejtje në këtë projektbuxhet, që më pas ne të shohim a kemi mundësi të ndikojmë diçka në lidhje me këtë. Komisionit u janë kthyer këto shkresa më vërejtje. Pra meqenëse nesër në seancë është parapa të miratohet buxheti i Kosovës, unë propozoj që secili nga ne që do ta merr fjalën, të theksoi që prioritet duhet të kenë segmentet e sigurisë në Kosovë. Gjithashtu tha se unë përkrah mendimin e juaj që në gjate mujorin e ardhshëm të bëhet rishikimi i buxhetit.

Agim Veliu tha ne nuk jemi të njoftuar në lidhje me këto shkresa, por unë mendoj që ne nuk do të kemi mundësi që të ndikojmë në buxhet mbas gjashtë mujorit të parë.

Rrustem Mustafa, unë mendoj se ne duhet të kërkojmë me përkushtim që sa i përket sektorit të sigurisë të rishqyrtohet buxheti, a pajtoheni me këtë?
Të gjithë anëtarët e komisionit u pajtuan me këtë propozim.

Pika e katërt: Shqyrtimi i planit të punës së komisionit, për këtë pik kryetari i komisionit i njoftoi anëtarët se ka hartuar një draft-plan të komisionit në të cilin janë përfshirë objektivat dhe organizimi i punës së komisionit, por në të nuk është përfshirë Agjenda Legjislative e cila pritet të vij në Kuvend të miratohet. Komisioni do të bashkëngjit planit të punës agjendën e ligjeve për të cilat komisioni ynë është funksional. Prandaj kërkojë nga të gjithë anëtarët e komisionit të angazhohen rreth planit të punës të cilë komisioni në një nga mbledhjet e ardhshme do ta miratojë. A ka dikush diçka për të thënë.

z.Naim Maloku, ky draft-program i përfshin të gjitha dhe mendoj që duhet ta mbështesim, prandaj propozoj të miratohet. Me këtë u pajtua edhe **z.Eqrem Kryeziu.**

z.Rrustem Mustafa theksoi se për hir të punës këtë plan-punë nuk do ta qesë në miratim sot, do ta miratojmë në mbledhjen e ardhshme në mënyrë që ta lexoni dhe shqyrtoni sa ma mirë.

Pika e pestë: Njoftimi nga OSBE për projektin e trajnimit, **z.Rrustem Mustafa** tha se mendoj se ky trajnim është i mirë dhe besoi se do të kishte qen mirë për ta ndjekur këtë trajnim. Ai fjalën ja dha **z.Armend Beka** përfaqësues nga OSBE-ja.

z.Armend Beka, i njoftoi anëtarët e komisionit në lidhje me agjendën e trajnimit dhe theksoi se plani ynë është që trajnimi të mbahet me datën 25 dhe 27 shkurt 2008.
Të gjithë anëtarët e komisionit u pajtuan në lidhje me mbajtjen e trajnimit.

Pika e gjashtë: Të ndryshme, z.Naim Maloku inicioi dy çështje: e para ishte numri i mbledhjeve të komisionit, duke theksuar se me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës janë parapara dy mbledhje në muaj, dhe gjatë atyre unë i kam përfshi të gjitha çështjet, mirëpo kur kanë qenë ligjet në procedim është deshtë të mbahen 8-9 mbledhje në muaj, andaj propozoj që mos të ketë nevojë çdo javë të mbahen mbledhje. Ndërsa pika e dytë është akuza e Kryeministrit për sabotazh në KEK, andaj kërkoj hulumtimin e procedimit të kësaj çështje.

z.Rrustem Mustafa tha se e di që me Rregullore të Kuvendit janë të parapara dy mbledhje në muaj, mirëpo tash e tutje unë do të jem çdo ditë këtu prandaj mund të shihemi më shpesh dhe të vendosim për mbledhje. Ndërsa sa i përket pikës së dytë jam i interesuar mu marr më shumë me çështje më të rëndësishme, prandaj nuk do ta ngris fare këtë çështje.

z.Gani Geci, pasi që jemi në prag të Pavarësisë desha të pyes se a duhet komisionit të jetë më tepër i njoftuar për çështjen e sigurisë dhe a duhet të jemi të involvuar se çka ka ndërmarr SHPK-ja dhe KFORI.

z.Rrustem Mustafa tha se për këtë është një garanci që janë duke u kujdesur rreth sigurisë, prandaj nëse ka diçka ma shumë ne jemi këtu.
Meqenëse nuk ka dikush diçka tjetër për të shtuar këtë takim e deklaroj të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:55

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit